



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 18 .6. 2019

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJET "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995 "PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË" I NDRYSHUAR

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 1.10.2018, 22.5.2019, 10.6.2019, 12.6.2019 dhe 18.6.2019, mori në shqyrtim dy projektligjet "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1. 1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Nisma e parë, e depozituar në Kuvend, është propozim i 37 527 shtetasve shqiptarë, dhe nisma e dytë vjen me propozim të një grupi deputetësh.

Meqenëse këto dy nisma kanë për objekt ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1. 1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të datës 29.5.2019 u vendos që nismat të shqyrtohen njëkohësisht nga komisionet parlamentare, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatorë për shqyrtimin e projektligjeve deputetët Adnor Shameti dhe Elena Xhina.

Në mbledhjet e Komisionit për të diskutuar mbi projektligjet, si dhe për të dhënë opinionin dhe propozimet e tyre ishin të pranishëm, përfaqësues të nismëtarëve nga shoqata "Animal Rescue Albania", ekspertë të misionit EURALIUS dhe OSBE, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJEVE

Projektligjet e paraqitur për shqyrtim janë propozuar nga mbi 20 000 zgjedhës, si dhe nga një grup deputetësh, sipas përcaktimeve të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës, dhe shoqërohen me relacionet përkatëse sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJEVE

1- Projektligji i propozuar nga 37 527 zgjedhës

Projektligji është bazuar në nenin 81 të Kushtetutës që rregullon procesin e nismës ligjvënëse, dhe ku parashikohet se *“të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës”*.

Konkretisht, ky projektligj vjen si nismë e 37 527 shtetasve shqiptarë, me të drejtë vote, të cilët propozojnë të shtohen disa dispozita të reja në Kodin Penal, me qëllim dënimin e dhunës ndaj kafshëve.

Projektligji, nga ana formale, është i shoqëruar me një relacion shpjegues mbi qëllimin e nismës, si dhe është shoqëruar me dokumentacionin që provon mbledhjen e mbi 20 mijë firmave Dokumentacioni shoqërues përmban formularin për nismën, ku është pasqyruar identiteti i zgjedhësit, numrin e kartës së identitetit, nënshkrimin e tij, si dhe numrin telefonik të kontaktit.

Projektligji ka si qëllim dënimin e rasteve të dhunës ndaj kafshëve, duke parashikuar të shkeljet konkrete si dhe sanksionet përkatëse.

Projektligji përbëhet nga 6 nene, në të cilat janë parashikuar si vepra penale:

- eliminimi i kafshëve me armë zjarri,*
- braktisja e kafshëve të shoqërimit,*
- tortura, helmimi, keqtrajtimi i tyre,*
- organizimi i ndeshjeve mes kafshëve që shkaktojnë vuajtjen apo torturimin e kafshëve,*
- Kryerja e eksperimenteve të jashtëligjshme me kafshë*
- Përdorimi i lëkurës së kafshëve të shoqërimit dhe individëve të faunës së egër, në rrezik zhdukjeje.*

2. Projektligji i propozuar nga deputetët

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara në projektligj kanë si qëllim rregullimin e dhe përmirësimin e dispozitave të Kodit Penal në përgjigje të zgjidhjes së problematikave të konstatuara kohët e fundit, konkretisht për:

- i. Mbrojtjen nga dhuna e profesionistit shëndetësor;
- ii. Mbrojtjen nga dhuna të policit, funksionarit publik, të zgjedhurit dhe personelit të shërbimit publik;
- iii. Ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike/ndalimi i zhurmave;

- iv. Mbrojtjen nga dhuna në sport;
- v. Mbrojtjen e të drejtës së autorit;
- vi. Ndalimin e veprimtarisë së lojërave të fatit;
- vii. Dekriminalizimin e gabimit mjekësor në rastet kur pasoja nuk vjen si rezultat i neglizhencës së mjekut;
- viii. Përdorimin e armëve dhe lëndëve plasëse pa leje të organeve shtetërore;
- ix. Mbrojtjen nga kafshët shoqëruese në publik;
- x. Mbrojtjen e mjedisit;
- xi. Sigurinë ushqimore.

Ashtu si dhe shpjegohet në relacionin shoqërues të projektligjit, rezulton se parashikimet aktuale në Kodin Penal nuk garantojnë parandalimin për disa kategori veprimesh të dhunshme ndaj policit, mjekut, sportistit, arbitrit, ndërmjetësit dhe trajnerit, funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve, apo atyre që shërbejnë në shërbimin publik. Dispozitat përkatëse në Kodin Penal për dënimin e këtyre fenomeneve ose kanë mangësi, ose sanksionojnë dënime të lehta apo nuk ekzistojnë. Me qëllim dënimin e çdo veprimi dhune dhe parandalimin e dhunës në shoqëri, propozohet me këtë projektligj ashpërsimi i dënimeve për veprat e dhunës si dhe përfshirja e veprave të reja penale për adresimin e duhur të çështjeve të dhunës si akte që ngarkojnë me përgjegjësi penale.

Në projektligj propozohet ashpërsim i dënimeve për mbajtjen e armëve, armëve shpërthyesë ose e lëndëve plasëse në kundërshtim me parashikimet ligjore apo pa leje të organeve kompetente si dhe të veprimeve që synojnë pengesat apo ndalimin me çdo mjet e mënyrë, të qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujqor e ajror. Këto ndryshime në Kreun VIII, Seksioni III “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, kanë si qëllim frenimin e përdorimit të armëve apo lëndëve plasëse si dhe parandalimin e veprimeve që pengojnë qarkullimin e transportit në kundërshtim me parashikimet ligjore.

Me qëllim ashpërsimin e dënimeve për krimet mjedisore si dhe transpozimin e disa direktivave evropiane në fushën e mjedisit, në projektligj propozohet të ndryshohen nenet 201-203 të Kreut IV “Vepra penale kundër mjedisit” si dhe të shtohen në këtë Kre dhe 5 dispozita të reja për veprat penale të kryera nga persona fizikë a juridikë, të cilat bien ndesh me legjislacionin specifik për mjedisin dhe për rrezatimet jonizuese dhe që rrezikojnë të shkaktojnë ose shkaktojnë dëm real mbi cilësinë e ajrit, ujit, tokës, bimët, kafshët, shëndetin apo jetën e njeriut.

Gjithashtu, projektligji adreson dhe disa ndryshime të rëndësishme që lidhen me sigurinë ushqimore, si një nga çështjet më aktuale, njëkohësisht më sensitive në ditët e sotme. Në projektligj propozohet rishikimi i dispozitave ekzistuese që lidhen me sigurinë ushqimore si dhe krijimi i figurave të reja të veprave penale, duke kriminalizuar fenomene/sjellje të cilat aktualisht, janë kategorizuar si forma të kundër-vajtjeve administrative, apo nuk kanë asnjë parashikim të mirëfilltë ligjor si shkelje por që për shkak të rëndësisë së marrëdhënieve juridike që synojnë të mbrojnë, natyrshëm duhet të klasifikohen si krime apo kundërvajtje penale.

Dhe në përfundim, në projektligj propozohen dhe disa ndryshime të tjera që kanë si qëllim:
-mbrojtjen e të drejtës së autorit;

- ashpërsimin e dënimeve për ushtrimin e veprimtarisë së jashtëligjshme të lojërave të fatit dhe bixhozit;
- vendosjen e sanksioneve për prishjen e qetësisë publike nga subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike;
- vendosjen e sanksioneve për shkeljen e rregullave të mbajtjes së kafshës së shoqërimit.

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJEVE

Dy projektligjet e depozituara, i janë nënshtruar një procesi të gjerë konsultimi publik, me pjesëmarrjen e organizatave dhe grupeve të interesit, të ekspertëve dhe të përfaqësuesve të institucioneve të fushës.

Në periudhën nëntor 2018-janar 2019 për projektligjin e propozuar nga shtetasit, janë zhvilluar disa tryeza diskutimi dhe është ngritur një grup pune me përfaqësues nga Euralius, Avokati i Popullit, Ministria e Drejtësisë, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Projektligji u është dërguar për mendim edhe disa organizatave të shoqërisë civile si dhe Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës.

Për projektligjin nismë deputetësh, janë zhvilluar disa tryeza konsultimi në grupin e punës të përbërë nga përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, ekspertë të Euralius dhe OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit si dhe të Shoqatës së Avokatëve Penalistë. Komente për projektligjin kanë ardhur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, OSBE, Shoqata e Prodhuesve shqiptarë, Bashkimi i Tregtarëve Shqiptarë si dhe nga Dhoma Amerikane e Tregtisë.

Propozimet e konkluduara në grupet e punës si dhe të ardhura nga grupet e interesit dhe institucionet e tjera, i janë bërë me dije Komisionit nga relatorët, dhe një pjesë e tyre janë pasqyruar dhe në propozimet e bëra nga relatorët gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjeve në Komision.

IV. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS E BE-SË

Sipas Opinionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit të Përafrimit të Përafrimit në Kuvend, si dhe nga rekomandimet dhe vlerësimet e paraqitura nga misioni EURALIUS, mbi përputhshmërinë e dispozitave të projektligjit me Aquis e BE-së, gjatë shqyrtimit të projektligjeve në Komision, për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të BE, janë bërë ndërhyrjet dhe rregullimet e nevojshme në disa nene të tij, me qëllim përputhshmërinë e tij me Direktivën 2008/99/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 19 Nëntor 2008 “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal”.

V. RREGULLIME TË TEKNIKËS LEGJISLATIVE DHE RIFORMULIME SIPAS NENEVE

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjeve, duke marrë parasysh dhe rekomandimet dhe propozimet e komisioneve për dhënie mendimi, miratoi këto ndryshime, të cilat në mënyrë të përmbledhur sqarohen në vijim për çdo nen :

▪ PROJEKTLIGJI I PROPOZUAR NGA SHTETASIT

Neni 1

Ndryshimet që propozohen të bëhen në këtë nen të projektligjit, kanë si qëllim në radhë të parë të përcaktojnë rastet se kur vrasja e një kafshe do të konsiderohet e dënueshme sipas Kodit Penal, pasi në praktikë një kategori kafshësh shërbejnë si bazë ushqimore. Prandaj është bërë parashikimi që është e dënueshme vetëm vrasja me dashje e kafshëve të shoqërimit.

Paragrafi 2 i dispozitës është konsideruar i panevojshëm pasi në përcaktimin e veprës penale në këtë rast nuk kanë rëndësi mjetet, kurse rastet e nevojës ekstreme janë të parashikuara në dispozita të tjera të Kodit Penal.

Dhe në fund, është bërë një vlerësim i masës së dënimit, pasi dënimet e propozuara në projektligj janë të larta dhe jo proporcionale.

Për sa i përket numërtimit të nenit që shtohet, bazuar në strukturën aktuale të Kodit Penal, propozohet që ky nen të shtohet pas nenit 207. Një numërtim dhe renditje përfundimtare e neneve do të bëhet në tekstin integral të projektligjit, pas të jenë miratuar të dy nismat për shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal.

Neni 2

Edhe në këtë nen konstatohet përdorimi i një terminologjie dhe teknike legislative jo në përputhje me atë të përdorur në Kodin Penal.

Në këtë nen është konstatuar si e papranueshme dhënia e dy dënimeve kryesore për të njëjtën shkelje, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, apo vendosja e gjobës në vlera monetare, në kundërshtim me nenin 34 të Kodit Penal.

Gjithashtu, në respektim të proporcionalitetit midis veprës së kryer dhe masës së dënimit, janë bërë rregullime edhe në masat e dënimit për çdo shkelje.

Prandaj neni është riformuluar tërësisht.

Neni 3

Edhe në këtë nen është konstatuar si e papranueshme dhënia e dy dënimeve kryesore për të njëjtën shkelje.

I gjithë neni është riformuluar, duke përcaktuar shkallët e veprës sipas rëndësisë dhe dëmit të shkaktuar, si dhe duke përshtatur masën e dënimit për çdo shkelje.

Neni 4

Kjo dispozitë propozohet të hiqet pasi kryerja e eksperimenteve të jashtëligjshme me kafshët është e dënueshme dhe trajtohet sipas ligjit “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”.

Nenet 5 dhe 6

Për sa u përket neneve 5 dhe 6 të projektligjit, çështjet që trajtojnë këto nene, janë të parashikuara dhe në projektligjin propozim i deputetëve, në nenin me titull “Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”.

Prandaj Komisioni vendosi që pas shqyrtimit dhe të projektligjit të dytë do të bashkohen këto nene dhe do të miratohet një variant i përbashkët.

2. PROJEKTLIGJI I PROPOZUAR NGA DEPUTETËT

Neni 1

Në këtë nen është shtuar togefjalëshi “*për shkak të detyrës*”, pasi duhet të theksohet në dispozitë se rrethana rënduese aplikohet vetëm kur vepra kryhet ndaj funksionarëve publikë apo personave të zgjedhur për shkaqe që lidhen me detyrën.

Neni 2

Neni 2 është riformuluar duke marrë parasysh propozimin e Komisionit të Punës dhe Shëndetësisë.

Në paragrafin e parë të nenit është bërë një saktësim i rasteve kur dëmtohet shëndeti, pra jo vetëm gjymtimi, si dhe saktësim i terminologjisë sipas legjislacionit për kujdesin shëndetësor.

Lidhur me parashikimin për infektimin HIV/AIDS, pas propozimeve edhe nga vetë mjekët që të mos jetë rrethane cilësuese, pasi shkenca e mjekësisë sot e shoh si sëmundje të mjekueshme HIV/AIDS, u vendos që ky paragraf të hiqet, pasi paragrafi i parë i dispozitës e përfshin edhe rastin e infektimit, që përbën dëmtim të përhershëm të shëndetit.

Neni 3

Pas konstatimit se në nenin 149 të Kodit Penal trajtohet mbrojtja e të drejtës së autorit, dhe ndryshimet që propozohen mund të inkorporohen në këtë nen, u vendos që të bëhen ndryshimet

në nenin 149 ekzistues, duke shtuar dhe një paragraf të ri për rastin kur vepra kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë.

Neni 4

Është bërë një riformulim i këtij neni, me propozim të relatores, me qëllim përputhjen e terminologjisë me ligjin për lojërat e fatit, duke hequr fjalët “lotari dhe bixhoz”. Gjithashtu, pas diskutimeve në komision, u vendos të mos vendosen sanksione ndaj pjesëmarrësve në lojërat e fatit, pasi qëllimi i dispozitës është parandalimi dhe dënimi për organizatorët dhe ushtruesit e veprimtarive të lojërave të fatit.

Neni 5

Neni është riformuluar me qëllim përputhshmërinë e plotë me direktivën europiane, si dhe për një formulim më të qartë për teknikë legislative. Në këtë nen është shtuar edhe parashikimi për ndotjen e ujërave, që është i domosdoshëm pas propozimit në projektligj për ndryshimin e nenit 203 ekzistues. Gjithashtu në këtë nen janë përfshirë dhe disa propozime të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Neni 6

- Lidhur me nenin 201/a që propozohet të shtohet, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Mjedisit dhe Euralius, në opsionet e tyre e konsiderojnë të panevojshëm. Elementet e kësaj vepre penale janë parashikuar dhe gjejnë zgjidhje në nenet e tjera të projektligjit për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, një nen kaq i gjerë mund të ketë probleme në drejtim të proporcionalitetit dhe të sigurisë .
Për më tepër, referuar në teorinë e të drejtës penale rastet e fatkeqësive trajtohen si “rast fatkeq” ose “rast fator” dhe në këtë kuptim “fatkeqësia” është e padënueshme.
- Në nenin 201/b që propozohet të shtohet, janë bërë disa saktësime për terminologjinë e përdorur nga direktiva, si dhe është bërë një rregullim i renditjes së paragrafëve, sipas rëndësisë së veprës, duke ndarë në dy paragrafë të veçantë dëmtimin e rëndë të shëndetit dhe vdekjen.
- Në nenin 201/c janë bërë disa saktësime për terminologjinë e përdorur nga direktiva, si dhe propozohet që të ketë një ndryshim në masën e dënimit, duke hequr minimumin e dënimit me burg.
- Në nenin 201/d janë bërë disa saktësime për terminologjinë e përdorur nga direktiva, si dhe është bërë një rregullim i renditjes së paragrafëve, sipas rëndësisë së veprës, duke hequr dhe dënimin me gjobë në paragrafin e parë.
- Në nenin 201/e janë bërë disa saktësime për terminologjinë e përdorur nga direktiva, si dhe është bërë një rregullim i renditjes së paragrafëve dhe dënimeve sipas rëndësisë së veprës.

Neni 7

Me qëllim përputhshmërinë me direktivën evropiane, që i trajton më vete, Komisioni vendosi që neni 202, që ndryshohet, të ndahet në dy nene, njëri për dëmtimin e specieve dhe tjetri për tregtimin e tyre.

Në formulimet që u janë bërë këtyre dy neneve, janë pasqyruar dhe propozimet e paraqitura në projektligjin e propozuar nga shtetasit, lidhur me mbrojtjen e specieve të faunës së egër në rrezik zhdukjeje.

Neni 8

Në nenin 202/a që shtohet janë bërë disa saktësime në titull dhe në përmbajtje, duke përcaktuar zonat e mbrojtura mjedisore.

Neni 9

Në nenin 203, që ndryshohet me nenin 9 të projektligjit, propozohet që të hiqet dënimi me gjobë, si dhe dënimi për veprën të bëhet nga një deri në shtatë vjet.

Neni 10

Neni 10 është riformuluar më qartë për teknikë legjislative, duke hequr formulime subjektive “qenve agresivë” apo “mbajtja pa kujdesin e duhur të kafshës”.

Neni 12

Në këtë nen, duke ndjekur të njëjtën logjikë si në nenin 237 që ndryshohet, propozohet që të shtohet dhe një paragraf që parashikon kanosjen në mjediset e institucioneve, me këtë formulim:

“Kur kjo vepër kryhet në mjediset e institucionit ku personi ushtron detyrën shtetërore, funksionin apo shërbimin publik, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.”

Neni 13

Neni 13 i projektligjit, që shton një nen të ri, 238/a, për pengimin e ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor, me propozim të relatores dhe pas diskutimit në Komision, u vendos që të hiqet.

Kjo pasi në nenin 235 ekzistues të Kodit Penal, në paragrafin e parë, parashikohet se “*Kundërshtimi që i bëhet një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën apo shërbimin sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj*”.

Nga anëtarët e Komisionit u vlerësua se me nenin ekzistues në punonjësit e shërbimit publik, përfshihen dhe profesionistët shëndetësorë, dhe me këtë nen kjo kategori gëzon më shumë mbrojtje.

Neni 14

Në paragrafin që shtohet në nenin 274 të Kodit Penal, është shtuar saktësimi “*që cenon dukshëm qetësinë në zona të banuara ose në mjedise publike*” për të cilësuar pasojën që vepra sjell. Gjithashtu është hequr masa e gjobës në vlera monetare pasi bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 34 të Kodit Penal.

Neni 15

Në nenin 274/a fjalët “mjediset sportive” të zëvendësohen me “ambiente sportive”, sipas terminologjisë së përdorur në ligjin për sportin. Gjithashtu në paragrafin e parë bëhet një shtesë me qëllim identifikimin e personave që kryejnë shkeljen.

Në nenin 274/b është bërë një ndryshim në renditjen e paragrafëve, sipas rrezikshmërisë së veprave. Paragrafi për hyrjen në fushën e lojës është ndarë në dy paragrafë, ku sipas rëndësisë dhe pasojës, ka ndryshuar dhe masa e dënimit.

Paragrafi i fundit, për sanksionet në rastin e aktiviteteve ndërkombëtare, është hequr.

Neni 16

Fjalja e dytë e paragrafit që shtohet në nenin 278, të riformulohet:

“Po kjo veprë, kur kryhet më shumë se një herë ose në sasi të mëdha, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet .”.

Neni 17

Në nenin 278/b që shtohet, të hiqet fjala “nukleare” pasi është e njëjtë me “bërthamore”.

Nenet 18 dhe 19

Në këto dy nene është bërë një saktësim, është hequr fjala “substancë”, pasi nuk gjendet në nenet 282 dhe 282/a që ndryshohen.

Neni 20

Në riformulimin që i është bërë këtij neni, janë hequr pijet dhe lëndë të tjera ushqimore pasi kategorizohen brenda ushqimeve. Gjithashtu hiqen nga përmbajtja e nenit edhe barnat e rrezikshme, pasi trajtohen në nenin 284/dt Kodit Penal.

Është bërë një ndryshim në masat e dënimit sipas rrezikshmërisë së veprave, duke rritur masën e dënimit për rastet e dëmtimit të disa personave.

Neni 21

Pas propozimit të relatores dhe diskutimeve në Komision, u vendos që neni 288/c të hiqet nga projektligji, pasi të gjithë elementet që parashikohen në këtë nen, që kanë të bëjnë me aftin e përdorimit të produkteve ushqimore, ezaurohen në parashikimet e nenit 288, i cili përfshin të gjithë rastet kur këto produkte sipas rastit, prodhohen, importohen, shiten etj., “në shkelje të kërkesave të legjislacionit të posaçëm”.

Lidhur me nenin 288/d të projektligjit, në paragrafin e parë të tij u bë dhe shtesa “që rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve,” me qëllim që neni të jetë në të njëjtën linjë me nenin 288, ku parashikohen pasojat e mundshme të veprës.

Pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, bazuar në nenin 71 të Rregullore së Kuvendit, janë depozituar edhe disa amendamente të ardhura nga deputetë si dhe nga Këshilli i Ministrave, me VKM nr.376, datë 5.6.2019.

Këto amendamente u diskutuan gjerësisht në mbledhjet e Komisionit, duke vlerësuar rëndësinë e tyre si dhe nëse janë të domosdoshme aktualisht. Për disa nga propozimet që kanë të bëjnë me ashpërsimin e masave të dënimit për ndërtimet e paligjshme, apo për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve për paracaktimin e rezultateve në garat sportive, anëtarët e Komisionit, pasi dëgjuan edhe opinionin e përfaqësuesit të Prokurorisë së Përgjithshme për zbatueshmërinë në praktikë të këtyre shkeljeve, dhe në mungesë të një argumentimi nga propozuesit për nevojën e rritjes së ndëshkueshmërisë, konkluduan se dispozitat aktuale të Kodit i japin zgjidhje tashmë problematikave në këto fusha, dhe nuk është e nevojshme të ndryshohen.

Në vazhdim të shqyrtimit të amendamenteve të propozuara, Komisioni miratoi disa ndryshime dhe shtesa në nenet 30, 43/b dhe 44 të pjesës së përgjithshme të Kodit si dhe një ndryshim të nenit 121 me titull “Ndërrhyrje të padrejta në jetën private”.

VI. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligjet janë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligjet janë paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi i shqyrtoi dy projektligjet në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi ndryshimet e paraqitura sipas tekstit integral bashkëlidhur, i

cili i përcillet për votim seancës plenare.

RELATORË

ELENA XHINA

ADNOR SHAMETI

KRYETAR

ULSI MANJA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

“PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, “KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 30, pas pikës10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“11. Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

^{1 1} Ky ligj është përafuar pjesërisht me Direktivën 2008/99/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 19 Nëntor 2008 “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal”, Numri CELEX 32008L0099, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 328, datë 6.12.2008, faqe 28-37”.

Neni 2

Pas nenit 43/a shtohet neni 43/b me këtë përmbajtje:

“Neni 43/b

Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë jepet nga gjykata për një kohë nga pesë deri në dhjetë vjet, ndaj personit që kryen një veprë penale që prek zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”.

Neni 3

Në paragrafin e dytë të nenit 44, togfjalëshi “...dhe 8...” zëvendësohet me “...8 dhe 11...”.

Neni 4

Në nenin 50 shtohet shkronja f/1, me këtë përmbajtje:

“f/1. Kur vepra është drejtuar ndaj personave të zgjedhur dhe funksionarëve publikë, për shkak të detyrës”.

Neni 5

Neni 96 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 96

Neglizhenca në trajtimin mjekësor

Neglizhenca në trajtimin mjekësor të të sëmurëve nga ana e profesionistit shëndetësor kur ka rrezikuar jetën e personit, apo ka dëmtuar rëndë shëndetin e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar vdekjen e personit, dënohet me burgim deri në dy vjet.”

Neni 6

Neni 121 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 121

Ndërhyrje të padrejta në jetën private

Vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi ose regjistrimi i fjalëve, fiksimi ose regjistrimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim i të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Shpërndarja, ofrimi për publikim apo publikimi me çdo mjet ose formë të komunikimit publik apo mënyrë tjetër, i të dhënave të marra në mënyrën e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet ndaj personave të mitur, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik apo nga personi që disponon këto të dhëna për shkak të detyrës shtetërore apo shërbimit publik, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.”.

Neni 7

Neni 149 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 149

Shkelja e të drejtave të autorit

Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht, shpërndarja, komunikimi në publik, shitja, ofrimi për shitje, përdorimi, furnizimi, eksportimi ose importimi për qëllime fitimi, i veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit, pa pëlqimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës, kur janë shkelur të drejtat vetjake ose pasurore të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim deri në tre vjet ”.

Neni 8

Neni 197 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 197

Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin

Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Po kjo vepër, nëse në lojë marrin pjesë persona nën moshën 18 vjeç, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik, që ka lidhje me veprimtarinë e lojërave të fatit, dënimi me burgim shtohet me një të katërtën e dënimit të dhënë.”

Neni 9

Neni 201 ndryshohet, si më poshtë vijon:

Neni 201

Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës

Ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimi i rëndë i kafshëve ose i bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, tej kufirit të normave të lejuara me ligj, dënohen me burgim deri në tre vjet.

Po kjo veprë, kur është kryer në zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e lehtë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.

Kur kjo veprë ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e rëndë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Po kjo veprë, kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë vdekjen e një ose disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 10

Pas neni 201, shtohen nenet **201/a, 201/b, 201/c, 201/d,** me këtë përmbajtje:

Neni 201/a

Menaxhimi i mbetjeve

Grumbullimi, transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin e venddepozitimeve si dhe veprimet e ndërmarra në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Po kjo veprë, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Ku nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 201/b

Transportimi i mbetjeve

Transportimi i mbetjeve që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga territori i Shqipërisë, në sasi jo-të papërfillshme, i kryer në një transportim të vetëm ose në disa transportime në dukje të lidhura me njëri-tjetrin, në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve

ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose burgim deri në pesë vjet.

Neni 201/c **Aktivitetet e rrezikshme**

Funksionimi i një impianti ku zhvillohet aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca apo preparate të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, të cilat shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë dëme të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Po kjo veper, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Neni 201/d

Materialet berthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme

Prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve berthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Po kjo vepër kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Ku nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë vjet deri në njëzetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

Neni 11

Neni 202 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 202

Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër

Vrasja, shkatërrimi, zotërimi, marrja e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.

Neni 12

Pas nenit 202 shtohen nenet 202/a dhe 202/b me këtë përmbajtje :

“Neni 202/a

Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër

Tregtimi i ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nën-produkteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”

“Neni 202/b

Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore

Veprimet që shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.”

Neni 13

Neni 203 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 203

Substancat ozon-holluese

Prodhimi, importimi, eksportimi, nxjerrja në treg ose përdorimi i substancave ozon-holluese duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.”

Neni 14

Pas nenit 207 shtohen nenet 207/a, 207/b, 207/c, 207/d, me këtë përmbajtje:

“Neni 207/a

Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit

Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.”

“Neni 207/b

Keqtrajtimi i kafshës

Keqtrajtimi ose torturimi i një kafshe, duke i shkaktuar dëmtime të përhershme shëndetësore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e kafshës, dënohet me burgim deri në gjashtë muaj.”

“Neni 207/c

Ndeshjet ndërmjet kafshëve

Promovimi, organizimi ose drejtimi i ndeshjeve ndërmjet kafshëve që shkaktojnë vuajtjen ose torturimin e kafshëve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Dhënia e kafshëve për ndeshje ose rritja dhe trajnimi i kafshëve me qëllim përdorimin apo shitjen për ndeshje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Vënia e basteve në ndeshje të zhvilluara midis kafshëve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy muaj.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e kafshës, dënohet me burgim deri në gjashtë muaj.”

“Neni 207/d

Braktisja e kafshës të shoqërimit

Kur nga braktisja e kafshës së shoqërimit ose nga mosvendosja e maskës mbrojtëse kafshës së shoqërimit, në ambiente publike ose në mjedise të hapura për publikun, kanë ardhur pasoja në dëm të shëndetit të një personi, dënohet me gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj.

Kur nga vepra penale ka ardhur plagosja e rëndë e një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur nga vepra penale ka ardhur vdekja e një personi, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.”

Neni 15

Neni 237 ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 237

Goditjet për shkak të detyrës

Goditjet ose vepra të tjera dhune ndaj punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore apo të shërbimit publik, dënohen me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj personit të zgjedhur apo funksionarit publik, për shkak të veprimtarisë së tij, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj punonjësit të policisë për shkak të veprimtarisë së tij dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj profesionistit shëndetësor për shkak të veprimtarisë së tij dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në mjediset e institucionit ku personi ushtron detyrën shtetërore, funksionin publik apo shërbimin publik, dënohet me burgim nga tre deri në pesë vjet.”

Neni 16

Neni 238 ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 238

Kanosja për shkak të detyrës

Kanosja serioze për vrasje apo për plagosje të rëndë, që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, dënohet me burgim deri në dy vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj personit të zgjedhur apo funksionarit publik, për shkak të veprimtarisë së tij, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj punonjësit të policisë për shkak të veprimtarisë së tij, kur cilësitë e personit janë të njohura ose të dukshme, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj profesionistit shëndetësor për shkak të veprimtarisë së tij, kur cilësitë e personit janë të njohura ose të dukshme, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në mjediset e institucionit ku personi ushtron detyrën shtetërore, funksionin apo shërbimin publik, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.””.

Neni 17

Në nenin 274 “Prishja e qetësisë publike” pas paragrafit të parë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Ushtrimi i veprimtarisë ekonomike që lëshon/gjeneron zhurmë në kundërshtim me ligjin apo në tejkalim të normave të lejuara me ligj, që cenon dukshëm qetësinë në zona të banuara ose në mjedise publike, dhe kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”.

Neni 18

Pas neni 274, shtohen nenet 274/a dhe 274/b, me këtë përmbajtje:

"Neni 274/a

Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv

Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, nga persona jashtë kësaj veprimtarie, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në ambiente sportive, më shumë se një herë, apo është kryer nga drejtues apo anëtarë të klubeve sportive, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet

“Neni 274/b

Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive

Hyrja në fushën e lojës, gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv, nga persona të paautorizuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

Kur nga kjo vepër ka ardhur pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarreve, flakadanëve, gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Neni 19

Në nenin 278, paragrafi i parë, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyese ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në shtatë vjet.

Po kjo veper, kur kryhet më shumë se një herë ose në sasi të mëdha, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet

Neni 20

Pas nenit 278/a, shtohet neni 278/b, me këtë përmbajtje:

“Neni 278/b

Prodhimi, mbajtja, tregtimi i armëve bërthamore ose kimike

Prodhimi, mbajtja, tregtimi i armëve bërthamore ose kimike të dëmtimit në masë të popullsisë, dënohet nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet burgim”.

Neni 21

Në nenin 282, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshon në: “Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse dhe djegëse”.
2. Fjaët “apo radioaktive” në paragrafin e parë shfuqizohen.
3. Shenja e pikësimit “presje” pas fjalës “lëndë plasëse” në paragrafin e parë ndryshohet në “ose”.

Neni 22

Në nenin 282/a, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshon si vijon: “Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese”.
2. Fjalët “dhe radioaktive” në paragrafin e parë shfuqizohen.
3. Shenja e pikësimit “presje” pas fjalës “i djegshëm” në paragrafin e parë ndryshohet në “ose”.

Neni 23

Neni 288, ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 288

Importimi, prodhimi, shitja dhe ruajtja e ushqimeve të rrezikshme për shëndetin ose jetën e njerëzve

Importimi, prodhimi, ruajtja, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër i ushqimeve ose futja në prodhimin e artikujve ushqimorë, e kimikateve, materialeve apo lëndëve shtesë, që rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve, në shkelje të kërkesave të legjisllacionit të posaçëm, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kur nga kjo vepër ka ardhur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave, dënohet me burgim nga 10 deri në 25 vjet.”

Neni 24

Pas nenit 288/b, shtohet neni 288/c dhe 288/d, me këtë përmbajtje:

Neni 288/c

Mashtrimi me produktet ushqimore

Importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, falsifikimi, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë në të cilët janë shënuar të dhëna të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, sasisë apo cilësisë së produktit apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, ose paraqitja e të dhënave të rreme në etiketimin e produkteve ushqimore, që rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda për shëndetin e njeriut, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 288/d

Prishja e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore

Prishja me dashje e shenjave të sigurisë të vendosura nga organet shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore për qëllime mbikqyrjeje, kontrolli ose pezullimi të veprimtarisë tregtare në mjediset ekonomike, mbi mjetet e transportit ose mbi mallra, me qëllim lëvizjen e mallrave ushqimore ose rifillimin e aktivitetit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 25

Neni 293 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 293
Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit

Vënia e pengesave ose ndalimi, me çdo mjet e mënyrë, i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujqor e ajror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI